

AMENDAMENTI NR. 1

i Kërkesës për Shprehje të Interesit për Kontraktor të Kontrollit të Cilësisë për Rindërtim Kadastral Ref nr: XK-KCA-101492-CS-QCBS

Hyrje

Ky amendament (në tekstin e mëtejme “Amendamenti”) është bërë më **09 gusht 2023** nga **Agjencia Kadastrale e Kosovës**, rr. “Arbënor e Astrit Dehari” nr. 25, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës (në tekstin e mëtejme “Blerësi”)

DUKE MARRË PARASYSH SE

- a) Agjencia Kadastrale e Kosovës me datën 02.08.2024 ka publikuar Kërkesën për Shprehje të Interesit për Rindërtim Kadastral Ref nr. XK-KCA-101492-CS-QCBS me qëllim të caktimit të një kompanie/konsorciumi për të vepruar si Operator i KC-së dhe ekzekutimit të KC-së të të gjithë punës së rindërtimit kadastral.
- b) Agjencia Kadastrale e Kosovës ka rishikuar Specifikimet e fundit Teknike për Rindërtim Kadastral (RK) që do të kryhet në deri në 115 zona kadastrale në mbarë Kosovën dhe një ndryshim i tillë do të rezultonte në ndryshime në Termat e Referencës për Kontraktorin e Kontrollit të Cilësisë për Rindërtim Kadastral.

PËR KËTË ARSYE, Agjencia Kadastrale e Kosovës pajtohet të bëjë Amendamentin nr.1 të Kërkesës për Shprehje Interesi të datës 02.08.2024 për Kontraktorin e Kontrollit të Cilësisë për Rindërtim Kadastral Ref. nr.: XK-KCA-101492-CS-QCBS në termat dhe kushtet e mëposhtme:

1. Seksioni “Objektivi i Detyrës” modifikohet për të lexuar si më poshtë:

AKK synon të kontraktojë një kompani/konsorcium për të vepruar si Operator i KC-së dhe për të ekzekutuar KC-në e të gjithë Rindërtimit Kadastral (të ndarë në 5 lote).

2. Seksioni “Fushëveprimi” modifikohet si më poshtë:

Në kuadër të REGIP, për Agjencinë Kadastrale të Kosovës një nga aktivitetet më të rëndësishme është projekti kapital i Rindërtimit Kadastral (RK). Në kuadër të REGIP-it janë planifikuar të zbatohen projekte të RK-së në 115 zona kadastrale me prioritet. Sipërfaqja e përgjithshme e planifikuar është 121,000 hektarë, ndërsa numri i përgjithshëm i parcelave është rreth

268,000. Në kuadër të këtij projekti pritet të krijohen rreth 70,000 objekte si njësi të reja kadastrale.

Programi i RK-së do të zbatohet nga Ofruesi i Shërbimeve (kontraktori që kryen rindërtimin kadastral) i cili do të punojë sistematikisht sipas zonës kadastrale. Puna do të kontrollohet në aspektin e cilësisë nga një Operator i KC-së (i angazhuar veçmas dhe që i përgjigjet AKK-së) dhe të gjitha ndryshimet kadastrale duhet të miratohen nga një komision i caktuar posaçërisht për RK. Në secilën zonë kadastrale, Ofruesi i Shërbimeve (OE) do të kryejë aktivitetet e Kontrollit të Cilësisë.

3. Të gjitha dispozitat e Kërkesës për Shprehje të Interesi të datës 02.08.2024 të cilat nuk janë në kundërshtim me termat dhe kushtet e këtij Amendamenti nr. 1 mbeten të pandryshuara.